

3



3. Kujdesi ndaj fëmijëve deri në 1 vjec:

Foshnjët kanë nevojë për figura rëferimi stabile që i mundësojnë fëmijës zhvillimin e marrëdhënie emocionale. Foshnjëve në strehim ofroni një ambient të ngrohtë familjar dhe keni parasysh që jeni duke e shoqëruar vetëm për një kohë të caktuar, dhe ofroni të gjitha shërbimet e nevojshme për mirëqenien e fëmijës gjatë periudhës së strehimit familjar të tij.

Janë katër elemente kyçe për të cilat ju duhet të kujdeseni për të miturit e kësaj grupmoshe:

→ **Ushqimi:** kujdesuni për ushqimin adekuat të fëmijës në mungesë të gjirit të nënës. Një nga ushqimet e mundura mund të jetë purea e hollë e përbërë nga patate ose përzjerje perimesh. Pureja i jep organizmit të fëmijës lëndë të reja për të cilat ai ka nevojë. Megjithatë për ushqime tjera konsultohuni me pediatrin. → **Higjiena:** mirëmbajtja e higjienës tek fëmijët e kësaj moshe është me rëndësi të veçantë për mirëqenien e tij, prandaj kujdesuni për pastrimin e fëmijës me preparate të rekomanduara dhe të testuara për fëmijë → **Shëndeti:** është e nevojshme në çdo moment ta observoni gjendjen shëndetësore të fëmijës, temperaturën trupore të tij, pamjen e lëkurës, ngjyrën e syve, nevojat fiziologjike (urinimi, tretja), dhe nëse vëreni ndonjë ndryshim ju duhet patjetër duhet të konsultoheni me mjekun pediatër pranë shtëpisë së shëndetit apo me personelin sanitar të pranishëm. → **Vaksinimi i rregullt:** në konsultim me menaxherin e rastit informohuni cilat vaksina fëmija duhet të marrë në bazë të kalendarit të vaksinimit. Vaksinimi është një mënyrë efektive dhe e sigurt për të mbrojtur fëmijët kundër sëmundjeve të rrezikshme për të cilat nuk ekziston ndonjë terapi e efektive për disa sëmundje që mund të jenë shkak i komplikimeve të rënda.

Jepni fëmijës sa më shumë vëmendje që mundeni, por nëse ende ndiheni se diçka nuk po shkon mirë dhe jeni në stres atëherë këshillohuni tek profesionistët që keni në dispozicion.

Amici dei Bambini
A FAMILY FOR EVERY CHILD

1



1. Çfarë duhet të bëj familja strehuese?

Të ofroj: ushqim të pasur dhe të larmishëm me vitamina dhe proteina sipas nevojës së fëmijut dhe rekomandimit të pediatrit, krevat të përshtatshëm për moshën dhe hapsirë të nevojshme për mësim, veshmbathje sipas stinëve, vizita të planifikuara tek pediatri dhe mjeku specialist përkatës → të nxisë pjesmarjen e fëmijut në lojra të ndryshme që e stimulojnë zhvillimin fizik, psikologjik dhe social të fëmijut → ambient të sigurt dhe mbrojtës → të zhvilloj marrëdhënie të besueshme të fëmijës brenda familjes përmes lidhjes emocionale të qëndrueshme në mënyrë që tek fëmija të krijohet ndjenja se është i pranuar si anëtar i familjes → të bashkëpunoj me fëmijën dhe të ndihmoj atë që të jetë në gjendje të shprehë mendimet, dëshirat dhe ndjenjat e tij → e të siguroj që në çështjet të cilat ndërlidhen me interesin e fëmijut mendimi i fëmijut kur kjo është e mundshme të merret në konsideratë → të ofroj ndihmë për fëmijën për mbajtjen e kontakteve me familjen biologjike dhe kthim në familje → të ndihmoj fëmijun për krijimin e rrjetit social të shëndosh (shkollë, lagje, klube sportive dhe kulturore) → të përgatisë fëmijun në bashkëpunim me të ndërlidhurit për forma alternative të jetesës (adoptimi, jetesa e pavarur në bashkësi etj) kur strehimi familjar nuk është alternative → mbrojtja e konfidencialitetit për fëmijën dhe familjen e tij biologjike → të njoh rëndësinë e mbajtjes së identitetit kulturor të fëmijës, kur raca ose kultura e familjes strehuese është e ndryshme nga ajo e fëmijës dhe të krijoj mundësi që ky dallim të përfillet gjatë qëndrimit të fëmijut në strehimit familjar → të ndihmoj dhe avokoj në bashkëpunim me OLF-dhe punonjësit social për gjetjen e familjeve të reja strehuese.

Amici dei Bambini
A FAMILY FOR EVERY CHILD



5a. Kujdesi ndaj fëmijëve të moshës 3-6 vjet

Fëmijët e kësaj moshë fillojnë të mësojnë cilat sjellje janë të pranueshme në shoqëri dhe cilat sjellje nuk janë të pranueshme, gjithashtu në këtë kohë ata fillojnë të ndajnë realitetin nga fantazia.

Ju mund të ndihmoni zhvillimin e drejtë të fëmijës në këtë moshë nëse ju:

→ Inkurajoni fëmijët për t'u përballur me sfida të reja si: kopshti, shkolla, apo socializimi me fëmijë të tjerë në vendin ku jetoni. → Filsoni për emocione në mënyrë që ata të mësojnë të shprehin dhe të lidhin emocionet e tyre me mendimet. → Përgjigjeni pyetjeve të tyre dhe jepni informata të sakta rreth personave dhe gjërave që i rrethojnë. → Shpërbleni sjelljen e mirë. Jepni instruksione të qarta dhe të thjeshta.

5b. Kujdesi ndaj fëmijëve të moshës 6 - 12 vite

Fëmijët në këtë moshë kanë nevojë të mësojnë për kufizimet dhe pse nevojiten ato. Ata duhet të identifikojnë dallimin mes nevojave dhe dëshirave, të njoftohen me rregullat e familjes dhe të mësojnë pasojat e thyerjes së rregullave.

Ju mund të ndihmoni në zhvillimin e fëmijës në këtë moshë nëse ju:

Jepni shumë dashuri dhe mbrojtje. → Inkurajoni ata të bëjnë gjërat në mënyrë të vetme. → Mbështetni ata në shkathhtësi që ata mësojnë dhe vendimet që marrin. → Të jeni të qartë lidhur me atë se për çfarë jeni ju përgjegjës dhe çfarë prisni prej tyre. → Vendosni kufizime të qarta dhe gjithashtu bëjini të ditur fëmijës në çfarë mund të negociohet dhe në çfarë jo. → Lëroni fëmijët të përjetojnë pasojat në ambient të sigurt dhe të mbrojtur. → Mësoju shkathhtësi të zgjidhjes së problemit → Bëju me dije se ju i doni ata edhe nëse nuk pajtoheni për ndonjë gjë.

5c. Kujdesi ndaj fëmijëve të moshës 12-18 vite

Në këtë kohë fëmijët bëjnë një kalim të rëndësishëm që është kalimi nga fëmijëria në pjekuri, gjë që shoqërohet gjithashtu me kalim në jetë më të pavarur.

Në këtë kohë është e vështirë mbajtja e linjave të komunikimit të hapur me fëmijën, përshkak të zhvillimit të shpejtë të tyre, në shtëpi mund të kalohet në situata të tensionuara.

Mos harroni se në çfarëdo moshë që është fëmija, ende ka nevojë për dashuri dhe mirëkuptim.

Do t'i ndihmoni komunikimit me fëmijën në këtë moshë nëse ju:

Jini të qetë, edhe nëse fëmija përpigjet të ju inatos ju. → Merru me veten, jepi kohë vetes më mirë sesa të inatosesh ose të mundohesh të diskutosh diçka për të cilën ju nuk mund të ndikoni. → Jepi mundësinë për të marr pjesë në diskutime. → Dëgjo çka thotë. → Respekto privatësinë e dhomës së tij/saj. → Mos e nënvlehtëso apo përqesh atë. → Rregullisht jep qasje pozitive. → Shmangu nga dhënia e ultimatumëve dhe krijimi i figurave autoritare. → Bisedo me atë kur bëni diçka së bashku, më mirë sesa të parapërgatisni bisedën duke e bërë të duket si ngjarje e madhe. → Trego se e mirëpret ndihmën e fëmijës në punët e shtëpisë. → Përqafojë dhe tregoni se e doni atë. → Mos u fokusoni në detaje, zgjedh gjërat për të cilat duhet të mos tërhiqesh dhe lërë disa gjëra të kalojnë.



6a. Kujdesi ndaj fëmijëve me nevoja te veçanta

Nëse kujdeseni për një fëmijë me nevoja të veçanta, keni parasysh idetë në vijim të nxjerra nga familjet e fëmijëve me nevoja të veçanta:

→ Fëmijët me nevoja të veçanta janë **para së gjithash** fëmijë. Sikur të gjithë fëmijët tjerë, ata kanë nevojë për dashuri, pranim, shoqëri, mundësi pjesëmarrje dhe mundësi për arritje. Mos u fokusoni në problemim por fokusohuni në potencialet individuale të fëmijës. → Ju keni burime të mundshme në dispozicion –terapistë ose profesionistë të tjerë të cilët mundësojnë shërbimet. Ndhuni të lirë të pyesni ata sa herë që keni nevojë. → Një diagnozë nuk tregon gjithçka. Secili fëmijë është i veçantë. → Dilni nga aktivitetet e përditshme me familjen dhe së bashku zhvilloni një plan të adresimit të nevojave të veçanta të fëmijës. Nëse ka ndonjë profesionistë që punon me fëmijën, atëherë ftoni edhe atë në diskutimet për fëmijën. → Planifikoni linjat e komunikimit me anëtarët e familjes dhe profesionistët. Ju duhet të jeni të aftë të kontaktoni ata kurdo që ju ndiheni se keni nevojë për udhëzime shtesë. → Mbani shënime në takime, kështu që mund t'i lexoni sa herë që ju duhen. Mbani shënime për fëmijën kur ju jeni duke i mësuar diçka apo duke e vëzhguar. → Kur ju e prezantoni fëmijën tek fëmijët e tjerë, kujtoni që secili është duke pritur nga ju sinjale lidhur me atë se si duhet të reagojnë. Këni kujdes sepse nëse ju ndiheni rehat dhe jo në siklet, këtë do ta bëjnë edhe të tjerët. → Planifiko për pajset e veçanta që mund të nevojiten ose furnizimet me barna që duhet të keni në dispozicion. → Ju kërkohet të bëni vetëm akomodim "të arsyeshëm" për fëmijën me nevoja të veçanta duke u bazuar në programin e kujdesit për fëmijën.

6b. Menagjimi i sjelljeve sfiduese

Fëmijët mund të kenë sjellje që ju doni të ndryshoni. Por para se të bëni ndonjë hap në këtë drejtim, keni parasysh se fëmijët lehtë bëhen konfuz gjatë ndryshimeve kështu që mbështetni ata për të bërë këto ndryshime dhe mos i dënoni ata nëse bëjnë gabime. Ajo që mund të bëni në rast se fëmija bën diçka gabim është largimi nga ndonjë aktivitet dhe dërgimi në dhomë ku ai është i sigurt, por para se të bëni këtë ju duhet të jeni të sigurt se fëmija e kupton arsyen pse ju po bëni këtë dhe gjithashtu të di kohen sa do të qëndroj në dhomë.

Kur ju edukoni fëmijët, ju ndihmoni nëse keni parasysh që: → Ky është mësim dhe jo dënim. Juve ju duhet të përsërisni shumë herë se kjo sjellje nuk është e duhur. → Fëmija ka nevojë të dëgjoj se është sjellja e papëlqyer - jo ai/ajo.

Nëse fëmija është agresiv, ju do të ndihmoni nëse: → Këni rregull të qartë se dhuna apo agresioni nuk është i pranueshëm në familje. → Kontrolloni programet televizive që ata janë duke shikuar dhe monitoro kohën që ata shpenzojnë në TV apo Internet. → Asnjëherë mos shpërble sjelljen agresive apo të dhunshme - cdo herë shoqëro atë sjellje me pasojë negative si p.sh dërgimi në dhomë të sigurt apo ndalja e TV. → Inkurajo fëmijën të flas rreth gjërave → Lavdo për gjërat e mira që bëjnë → Shpërble për ndryshime pozitive të sjelljes.

Nëse jeni të preokupuar për gjërat e tjerë atëherë keni parasysh: → Fëmija nuk ka të njëjtën ide për të vërtetën sikur i rrituri. → Ata mund veç të fantazojnë dhe mund të flasin për diçka që ata dojnë që të jetë e vërtetë. → Jini të besueshëm – mos gënjeni fëmijën pasi që fëmija mund të kap ndonjë gënjeshtër qoft "për të mirë" dhe mund të mos jetë në gjendje të bëjë dallimin mes këtyre gënjeshtërve dhe ato që janë më të rënda dhe serioze. → Shpërble kur tregojnë të vërtetën edhe nëse tregon diçka që nuk do të doje ta dëgjoje.

4



4. Kujdesi ndaj fëmijëve 1-3 vjet

Kur jeni të angazhuar me fëmijë, si me fëmijët që e kanë fatin të jetojnë me familjet e tyre biologjike, ashtu me fëmijët që janë të largur nga prindërit e tyre biologjik, çdo herë keni para sysh aspektin e rritjes dhe zhvillimit sa më adekuat të fëmijës duke u bazuar në nevojat e fëmijës. Siq dihet, secili fëmijë është i ndryshëm nga tjetri prandaj secili fëmijë në strehim ka nevojat specifike të tij për rritje, zhvillim dhe edukim. Në përgjithësi fëmijët e kësaj grupmoshe ende kanë nevojë për lidhje emocionale e cila mund të ju ofrohet nga prindërit strehues dhe nga anëtarët tjerë të familjes. Për rritje dhe zhvillim të mirëfilltë të fëmijës të kësaj grupmoshe, mbajmë mend dy elemente bazë: Mirëqenien: Vëmendje e veçant duhet t'i kushtohet ushqimit adekuat të pasur me kalori të ndryshme sepse ushqimi është një nga faktorët kryesor për mirëqenien dhe shëndetin individual i cili influencon zhvillimin fizik dhe mental të një individi. Ushqimi adekuat në këtë moshë parandalon sëmundjet të ndryshme në moshën e pjekurisë. Gjithashtu edhe rregullat e ushqimit janë një mjet i rëndësishëm i edukimit sepse rregullat ushqimore kryesisht formohen në këtë grupmoshë të fëmijëve. → **Edukimi:** edukimi ju transmetohet fëmijëve qysh në moshë të hershme duke filluar gradualisht me pak rregulla por të karta, prandaj sa më parë që ju mësohen fëmijëve sjelljet adekuate është më mirë sepse sjellja e mirë në shoqëri do ta bëjë të ndihet mirë në të ardhmen e tij si i rritur. → **Edukimi fillon në familje:** mësoni fëmijën që të ju përshëndet juve apo të tjerët me fjalët: Faleminderit, Ju lutem, A mundem, etj. Fëmija gjithashtu mëson në shtëpi si duhet të ulët në tavolinë për të ngrënë dhe për të mos luajtur me ushqim. → **Respektimi i të tjerëve dhe i hapsirave të lojës:** spjegoni si duhet të sillet mirë me fëmijët e tjerë, p.sh. që nuk duhet t'i shtyj ata gjatë lojës, nuk duhet t'ua thej lodrat të tjerëve, etj. Mësojeni që duhet të respektohet hapësira publike sepse është e të gjithëve dhe të gjithë kanë të drejtë të luajnë, njëkohësisht transmetoni porositë e rëndësishme për të respektuar ambientin. → **Jepni komplimente për sjelljet e mira:** sa herë që fëmija bën një sjellje të mirë inkurajone duke e përgezuar me fjalët: të lumtë, je shumë i sjellshëm, etj., dhe kur është e mundur të shpërblehet me ndonjë dhuratë të vogël sepse në këtë mënyrë fëmija do të stimulohet për të përsëritur sjelljen pozitive. → **Mos u hidhëroni me fëmijën:** jepni disa prioritete në të mësuarit e sjelljes së edukuar të fëmijës dhe mos prisni rezultate të menjëhershme sepse sjelljet mësohen në mënyrë progresive dhe duke i përsëritur vazhdimisht ato. → **Jepni shembull të mirë në familje:** fëmijët janë vëzhgues shumë të mirë dhe marrin çdo sjellje të prindërve më shumë se fjalët e tyre, prandaj kujdesuni për sjelljet e përditshmërisë suaj para fëmijëve; → **Lexoni fëmijës përralla dhe tregime:** te lexuarit e përralles është i dobishëm për fëmijët e për zhvillimin e tij intelektual, emocional dhe të krijimit të marrëdhënieve shoqërore, prandaj mundohuni në kohë të caktuar para gjumit të lexoni nga një pjesë tregimi në mënyrë që të nxitet krijimi i shprehisë dhe dëshirës për lexim. Gjithashtu kujdesuni për të komentuar personazhet e tregimit në mënyrë që të zhvillohet edhe imagjinata e fëmijës; → **Luani me fëmijën:** në secilen stinë lojërat në hapësirë janë të dobishme për fëmijën, andaj kujdesuni të luani sa me shpesh së bashku me fëmijën sepse është mënyrë ideale që fëmija të ushtroj aktivitetin fizik dhe njëkohësisht të defrehet. Prandaj, organizo edhe lojëra me fëmijë tjerë moshatarë sepse lojërat e përbashkëta nxisin socializimin, këmbimin me të tjerët dhe edukimin e fëmijës; → **Shikoni film vizatimor së bashku me fëmijën:** Mundësoni fëmijën të shikoj programe televizive për fëmijë por kujdesuni që aktiviteti i tillë të mbikqyret nga të rriturit.




2. Çfarë mund të kërkoj Familja strehuese nga Qendra e Punës Sociale?

Në të gjitha rastet kur kemi të bëjmë me:

Lëndime të lehta dhe lëndime të rënda me rrezik jete të për fëmijën, infeksion të lëkurës / traktit urinarë/organeve të frymarjes , temperaturë, anemi ,ecje dhe folje të vonuar, humbje të oreksit apo ngrënie të pa kontrolluar, shtim apo humbje peshe , vakcionimi i rregullt dhe reagim ndaj vakcines etj → Regjistrimi i fëmijut/të riut në instiucionet edukative para shkollore , fillore dhe të mesëm,përcjellja e sjelljeve dhe suksesit të fëmijut /të riut në shkollë,ndërlidhja në aktivitetet jashtë shkollës- klube kulturore dhe sportive → ndarjen e informatave për fëmijën në drejtim të shërbimeve të tjera → format e mbajtjes së kontakteve dhe shpeshësinë e tyre me familjen adoptuese dhe familjen biologjike → lëvizjen e fëmijut jashtë shtetit → vështirësit rreth rregullsisë së pagesës për fëmijën në strehim familjar; kompenzimin e shpenzimeve për barnat → ndërrimin e përkohshëm / përhershëm të vendëbanimit të familjes strehuese → Sëmundjet e prindërve strehues apo vdekja

është e DREJTE dhe OBLIGIM i prindërve strehues të kërkojnë konsultime, këshilla, takime të rregullta dhe sipas nevojës edhe trajnime bazike që nderlidhen me interesin e fëmijut gjatë qëndrimit të tij të përkohshëm në strehim familjar nga Menaxheri i Rastit/ Kujdestarit i caktuar nga QPS.

Amici dei Bambini
A FAMILY FOR EVERY CHILD



STREHIMI FAMILJAR



Cooperazione Italiana
allo Sviluppo
Ministero Affari Esteri

Materiale prodotto con il contributo della Cooperazione Italiana allo sviluppo
Progetto AID9497/AIBI/KOS "Rafforzamento dei servizi in favore dei minori
in carico ai centres of social work del Kosovo per motivi familiari"

Amici dei Bambini
A FAMILY FOR EVERY CHILD